abkons

LOCAL Knowledge, GLOBAL Standarts

KODI I SJELLJES

JETOJMË SIPAS VLERAVE TONA

Si i arrijmë rezultatet është po aq e rëndësishme sa dhe vetë rezultatet

Përditësuar: Tetor 2021

CONTENT

I. Vlerat Tona fq 6

II. Bërja e Biznesit sipas Abkons fq 9-13

2.1 Angazhimi ynë
2.2 Kush do të zbatojë kodin tonë
2.3 Si ta përdorim Kodin
2.4 Çfarë pritet nga ne
2.5 Pritshmëri më të larta për ata që janë në pozicione menaxhuese
2.6 Pajtueshmëria me ligjet dhe rregulloret

III. Të kërkosh udhëzime dhe raportimi i shkeljeve të integriteti fq 14-17

3.1 Të kërkosh Udhëzime
3.2 Raportimi i shkeljeve të integritetit
3.3 Linja e integritetit
3.4 Jo Hakmarrjes - Shpagimit
3.5 Detyrimi për të Bashkëpunuar

IV. Integriteti ndaj njëri - tjetrit fq 19-23

4.1 Respektimi i të Drejtave të Njeriut
4.2 Promovimi i mundësive të barabarta dhe diversitetit 4.3
Krijimi i një mjedisi pa diskriminim dhe ngacmime
4.4 Sigurimi i një mjedisi pune të shëndetshëm dhe të sigurt
4.5 Respektimi i privatësisë

V. Integriteti ndaj komunitetit dhe mjedisit **fq 24-31**

5.1 Zhvillimi i komuniteteve që ndikohen nga Ne
5.2 Mbrojtja e mjedisit
5.3 Ndalimi i rryshfetit dhe korrupsionit
5.3.1 "Pagesat Lehtësuese"
5.3.2 Dhuratat, argëtimet dhe mikpritja
5.3.3 Palët e treta
5.3.4 Kontributet e bamirësisë dhe sponsorizimet
5.4 Kundër pastrimit të parave
5.5 Lobimi dhe aktivitetet politike

VI. Integriteti ndaj partnerëve **fq32-37**

6.1 Mbrojtja nga prokurimet jo etike
6.2 Shmangia e konflikteve të interesave
6.3 Ruajtja e saktësisë së biznesit dhe e të dhënave financiare
6.4 Ruajtja e aseteve të ABKONS
6.5 Shmangia e tregtisë së brendshme
6.6 Komunikimi me partnerët e jashtëm
6.7 Përdorimi i medias sociale

VII. Integriteti ndaj tregut **fq 38-39**

7.1 Antitrusti
7.2 Mbledhja e informacionit për konkurentë

VIII. Zbatimi Praktik **fq 40-41**

VLERAT
TONA

Vlerat e ABKONS-it janë themeli i Kodit të Sjelljes

Ekselenca

Punojmë së bashku për të qenë më të mirët

Tregoni përkushtim, motivim dhe pasion.

Kapërceni sfidat duke bashkëpunuar për të arritur zgjidhjet më cilësore.

Përpiquni për përmirësim dhe zhvillim të vazhdueshëm të aftësive dhe njohurive tuaja.

Mbani një qëndrim të hapur ndaj ndryshimeve dhe përshtatuni shpejt.

Njerëzit

Të respektuar dhe mendjehapur

Trajtoni çdonjërin me respekt dhe dashamirësi. Vlerësoni diversitetin kulturor, gjinor, të moshës dhe personalitetit.

Krijoni dhe rrisni marrëdhënie besimi afatgjata me palët kryesore të interesit.

Arrini rezultatet më të mira duke punuar së bashku.

Integriteti

Bëni atë çfarë thoni dhe thoni atë që bëni

Veproni në pajtueshmëri me udhëzimet e kompanisë, Kodin e Sjelljes dhe vlerat tona.
Shfaqni një sjellje të ndershme, të sinqertë dhe të vërtetë.
Jini krenar për kompaninë dhe rolin tuaj.
Shprehni mendimin tuaj dhe qendrojini besnik vendimeve të marra.

Përgjegjësia

Veproni me siguri dhe kujdes për të ardhmen

Tregoni kujdes ndaj individit, shoqërisë, natyrës dhe burimeve.
Angazhohuni plotësisht në standartet dhe masat e sigurisë.
Kujdesuni për njëri-tjetrin dhe tregoni tolerancë zero ndaj dëmit.
Tregoni përgjegjësi ndaj kompanisë dhe veproni me kujdes.

BËRJA E BIZNESIT SIPAS ABKONS

2.1 Angazhimi ynë

Ne zhvillojmë biznesin sipas mënyrës së ABKONS çdo ditë. Ne jemi krenar për çfarë ne arrijmë dhe si e arrijmë atë. Ne veprojmë në përputhje me kodin tonë dhe kemi si qëllim të jemi një kompani e mirë që është e angazhuar të veprojë me integritet në çdo aspekt.

Integriteti ndaj njëri-tjetrit: ne mbështesim një grup pune të shumëllojshëm dhe promovojmë një mjedis pune bazuar dhe mbështetur në respektin dhe dëshirën e mirë.

Integriteti ndaj komunitetit dhe mjedisit:
Ne investojmë në përmirësimin e komunitetit.
Veprimtaria e kompanisë sonë ndikon dhe është në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.
Ne i përdorim burimet me përgjegjshmëri dhe punojmë për të minimizuar impaktin (ndikimin) negativ që projektet tona do të kenë në ambietin rrethues.

Integriteti ndaj partnerëve: Ne punojmë fort për të ndërtuar një kompani në pajtim me standartet më të larta etike që shfaqin vlerat e partnerëve dhe që riafirmojnë besimin që investitorët kanë tek ne.

Integriteti ndaj tregut: ne jemi krenar pasi konkurrojmë me ndërshmëri dhe integritet. Ne kurrë nuk përdorim praktika të pandershme.

2.2 Kush do ta zbatojë kodin tonë

Ky Kod zbatohet nga kompania ABKONS dhe punonjësit, partnerët e kompanisë, palët e treta dhe të tjerë që veprojnë për dhe në emër të ABKONS.

Në këtë Kod fjala ABKONS do të thotë: "Kompani konsulente e regjistruar nën emrin ABKONS Sh.p.k".

Punonjës do të thotë:
Njerëz të punësuar direkt nga ABKONS
Punonjës të nënkontraktuar të ABKONS

ABKONS mbështetet në ekspertizën e punonjësve të tij dhe palëve të treta për mbarëvajtjen e kompanisë. Pritshmëria ndaj këtyre palëve të treta është që të zbatojnë parimet e përcaktuara në kodin e ABKONS si dhe çdo lloj dispozite kontraktuale të zbatueshme kur ata punojnë për llogari të ABKONS.

Në palët e treta përfshihen: kontraktorët, furnitorët, agjentët, ndërmjetësit, lobistët, konsulentët dhe këshilltarët.

ABKONS do të marrë masat e nevojshme kundër punonjësve, palëve të treta dhe të tjerëve të cilët veprojnë për dhe në emër të ABKONS, por që nuk ndjekin parimet e tij.

Në të gjithë kodin ne përdorim termin "NE" duke iu referuar të gjithë punonjësve individualisht, partnerëve të shoqërisë, palëve të treta dhe të tjerëve të cilët veprojnë për dhe në emër të ABKONS

2.3 Si ta përdorim Kodin

Leximi dhe përkrahja e Kodit ndihmon secilin prej nesh në kryerjen e biznesit sipas mënyrës së ABKONS. Kodi ynë nuk mund të parashikojë çdo situatë që ne mund të hasim, gjithsesi do të na ndihmojë të marrim vendime të shëndetshme dhe etike. Kodi shërben si një udhërrëfyes që i referohet politikave të ABKONS, ligjeve dhe rregullorëve në fuqi që ne duhet t'i dimë në mënyrë që të veprojmë në përputhje me pritshmëritë e ABKONS. Si gjithmonë, ABKONS mbështetet tek gjykimi juaj i mirë dhe nevoja që ju keni për të kërkuar ndihmë. ABKONS respekton të gjitha normat ligjore të Republikës së Shqipërisë. Kodi ynë është aprovuar nga partnerët e shoqërisë ABKONS.

Çdo ndryshim i këtij kodi do të kryhet me miratimin e të gjithë partnerëve të ABKONS. Pritshmëria është që ne të familjarizohemi me kodin dhe t'i bindemi atij. Nga ne pritet që të kryejmë të gjitha trajnimet e nevojshme në kohë dhe të jemi të përditësuar me standartet dhe pritshmëritë. Çdo vit ABKONS kërkon kryerjen e një çertifikimi mbi pajtueshmërinë e Kodit.

2.4 Çfarë pritet nga ne

Nga ne pritet që:

Të veprojmë gjithmonë me profesionalizëm, ndershmëri dhe etikë kur veprojmë për dhe në emër të ABKONS;
Të kryejmë të gjitha trajnimet e kërkuara në kohë dhe të përditësohen në lidhje me standartet aktuale dhe pritshmëritë;
Të raportojmë shqetësimet rreth shkeljeve të mundshme të ligjeve, rregulloreve apo kodit tonë (T'i raportojmë drejtuesit të grupit ose secilit prej burimeve të listuara në Kod).
Të bashkëpunojmë dhe të themi gjithë të vërtetën kur përgjigjemi ndaj një hetimi apo auditimi dhe të mos prishim kurrë të dhënat kur kemi të bëjmë me një hetim ose pritet të bëhet një hetim.

2.5 Pritshmëri më e lartë për ata që janë në pozicione menaxhuese

Ndërsa Kodi ynë është i zbatueshëm për të gjithë ne, ndaj pozicioneve menaxhuese pritshmëria jonë është më e lartë për shkak të rolit të tyre drejtues në ABKONS. Kjo do të thotë që ata jo vetëm që duhet të zbatojnë përditë këto parime të kodit por duhet gjithashtu:
a) të jenë proaktivë, të diskutojnë dhe trajtojnë me të tjerët situatata problematike në lidhje me etikën;

b) të krijojnë një mjedis ku të gjithë duhet të ndihen të lirë për të bërë pyetje dhe për të raportuar shkelje të mundshme të kodit dhe politikave;
c) mos i kërkoni dhe mos i bëni presion askujt

për të bërë dicka të cilën ju vetë e keni të ndaluar ta bëni.

Në qoftë se ju menaxhoni palë të treta sigurohuni që ata i kuptojnë detyrimet e tyre etike dhe të pajtueshmërisë dhe raportoni çdo shkelje të mundshme nga palët e treta.

2.6 Pajtueshmëria me Ligjet dhe Rregulloret

Ne duhet të zbatojmë ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Shqipërisë. Ne kemi përgjegjësinë të marrim njohuritë e nevojshme mbi legjislacionin dhe rregulloret që lidhen me veprimtaritë tona.
Prezumimi i "njohjes" së Ligjit dhe barazia përpara tij. Askush nuk përjshtohet nga përgjegjësia (civile. administrative, penale) me arsyetimin e mosnjohjes së ligjit.

KËRKIMI I UDHËZIMEVE DHE RAPORTIMI I SHKELJEVE TË INTEGRITETIT

3.1 Të kërkosh udhëzime

Ne mund të hasim situata në të cilat jemi të pasigurtë se çfarë duhet bërë. Nëse ju keni pyetje rreth Kodit tonë ose një situate specifike kontaktoni me një nga burimet e mëposhtme:

- Menaxherin/Drejtuesin e drejtpërdrejtë të linjës (në rastin kur je një punonjës, i punësuar);
- Përfaqësuesin e kontratës (në rastin e një pale të tretë);
- Oficerin e pajtueshmërisë së ABKONS personalisht, me telefon ose me e-mail në adresën compliance@abkons.com.
- Departamentin e Pajtueshmërisë ose Departamentin e Burimeve Njerëzore.

3.2 Raportimi i shkeljeve të integritetit

Nëse viheni në dijeni të një situate ose dyshoni se ka shkelje të kodit tonë, ligjit ose politikave të ABKONS, ju jeni i inkurajuar të raportoni sipas procedurave të mëposhtme:

- Silleni atë (shqetësimin) në vëmëndje të drejtuesit tuaj të drejtpërdrejtë;
- Njoftoni oficerin e pajtueshmërisë së ABKONS personalisht, me telefon ose me e-mail ne adresën compliance@abkons.com;
- Në vartësi të natyrës dhe vendodhjes së çështjes, raportimi mund të bëhet tek Linja e Integritetit që është: +355 (0) 69 70 34 779.

3.3 Linja e Integritetit

Linja e integritetit vihet në punë nga një palë e tretë e pavarur dhe është në punë 24 orë gjatë gjithë javës. Telefonat nuk regjistrohen dhe nuk gjurmohen. Çdo informacion trajtohet duke ruajtur gjithë konfidencialitetin e mundshëm. Të tregosh identitetin tënd kur bën raprotimin do të ndihmojë ABKONS (maksimalisht) gjatë investigimit të mundshëm. Në qoftë se nuk ndihesh komod për të treguar identitetin tënd, ju mund të raportoni si anonim. Pavarësisht se si zgjidhni të raportoni, të gjitha raportimet e shkeljeve faktike apo të dyshuara do të bëhen me seriozitet dhe në mënyrë të shpejtë. Personeli i duhur do të hetojë me kujdes të gjitha raportimet dhe ABKONS do të ndërmarrë veprimet e duhura.

3.4 Jo Hakmarrjes – Shpagimit

ABKONS është i vetëdijshëm se për të ruajtur një kulturë integriteti ai duhet të na mbrojë kur raportojmë në mirëbesim shkelje faktike apo të dyshuara. Për rrjedhojë ABKONS ndalon rreptësisht kundërveprimet hakëmarrëse ndaj nesh për raportimin në mirëbesim të një shkeljeje të mundshme. Prandaj ABKONS ndalon në mënyrë absulute aktet e hakëmarrjes kur ne raportojmë një shkelje të mundshme në mirëbesim. Të raportosh në mirëbesim do të thotë të japësh të gjithë informacionin që ke dhe që ti beson që është i vërtetë. Individë të cilët hakmerren ndaj një personi i cili ka bërë një raportim në mirëbesim ose që ka marrë pjesë në një hetim do të jenë subjekte të masave disiplinore përfshirë edhe zgjidhjen e kontratës. Nëse ju besoni se ndaj jush po kryhen veprime hakmarrëse konsultohuni me një nga palët e listuara tek 3.1, që ju mendoni se do t'i marrë në konsideratë seriozisht shqetësimet tuaja.

3.5 Detyrimi për të bashkëpunuar

ABKONS i heton me kujdes të gjitha raportet e sjelljes së gabuar në pajtim me kërkesat e rregulloreve, udhëzimeve, Kodit të Sjelljes, vlerat dhe politikat e saj. Për ta ndihmuar këtë proces ne duhet të bashkëpunojmë plotësisht dhe me ndershmëri në një hetim të plotë e të gjithanshëm për të parandaluar e identifikuar çdo aktivitet jo ligjor ose jo etik. Hetimi do të trajtohet në konfidencialitet të plotë dhe ndaj asnjërit nuk do të ketë shpagim (hakmarrje) për një gjë të tillë.

Çdo punonjës i ABKONS kur konstaton elementët e një vepre penale duhet të informojë subjektet e listuara në pikën 3.1 të këtij Kodi, këta të fundit raportojnë tek drejtuesit e tyre dhe kur ekzistojnë kushtet ligjore, rasti kallëzohet në organet kompetente.

INTEGRITETI NDAJ NJËRI - TJETRIT

Në ABKONS suksesi ynë varet nga respektimi që secili prej nesh i bën të drejtave të atyre që punojnë në kompaninë tonë dhe nga inkurajimi i një komunikimi të hapur. Ne përpiqemi të marrim në konsideratë çdo të dhënë të bashkëpunëtorëve tanë dhe të dëgjojmë opinionet e tyre. Ne të gjithë kemi të drejtë të kemi opinionet tona dhe nga ne pritet që të respektojmë pikëpamjet e të tjerëve.

4.1 Respektimi i të Drejtave të Njeriut

ABKONS vepron në pajtueshmëri me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, Konventat ndërkombëtare të punës dhe është angazhuar të zbatojë parimet e përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në pajtim me përgjegjësinë e ABKONS duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Ne i trajtojmë të gjithë me ndershmëri, respekt dhe dinjitet.

4.2 Promovimi i mundësive të barabarta dhe diversiteti

Ne marrim vendime të cilat promovojnë mundësi të barabarta dhe diversitet që nuk bazohen në gjini, besim, origjinë kombëtare, paaftësi fizike, moshë, orientim seksual, status familjar, opinion politik apo karakteristika të tjera që mbrohen nga ligji.

4.3 Krijimi i një mjedisi pa diskriminim dhe ngacmim

ABKONS është i angazhuar për të krijuar një mjedis pune pa diskriminim dhe ngacmime. Ne nuk do të tolerojmë asnjë formë diskriminimi dhe ngacmimi bazuar në gjini, besim, origjinë kombëtare, paaftësi fizike, moshë, orientim seksual, status familjar, opinion politik apo karakteristika të tjera që mbrohen nga ligji.

4.4 Sigurimi i një mjedisi pune të shëndetshëm dhe të sigurt

4.4.1 Shëndeti dhe Siguria në vendin e punës

Suksesi i ABKONS varet në krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë ata që punojnë për kompaninë dhe që ndikohen nga aktiviteti ynë. Njerëzit janë burimi ynë më i rëndësishëm, kështu që siguria është prioriteti ynë në të gjithë nivelet e kompanisë sonë. Pritshmëria jonë është që askush të mos vritet dhe dëmtohet, kjo do të thotë që ne të përpiqemi të arrijmë zero dëmtime dhe sëmundje profesionale. Për të parandaluar dëmtimet dhe sëmundjet profesionale ne duhet:

Të zhvillojmë një kulturë që na inkurajon të marrim përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë;

Të sigurohemi që shëndeti dhe siguria janë të integruara në të gjithë aktivitetin dhe që ne kemi marrë trajnimet e nevojshme dhe mbështetje për ta arritur këtë synim;

Të familjarizohemi me procedurat e ABKONS lidhur me shëndetin dhe sigurinë;
Abkons ka detyrimin për të instruktuar punonjësit dhe palët e treta në lidhje me standartet dhe masat e sigurisë në punë. Instruktimi materializohet nëpërmjet nënshkrimit në dokumentat përkatëse.

Të sillemi personalisht në mënyrë të sigurt dhe të mos rrezikojmë sigurinë e të tjerëve;

Të marrim të gjitha masat e nevojshme parandaluese kur përdorim makineritë ose pajisjet e rënda;

Të raportojmë aksidentet;

Të sjellim në vëmendje të drejtuesve rreziqet e moszbatimit të rregullave dhe standarteve;

Të dimë të veprojmë në raste emergjence.

4.4.2 Mjedis pa substanca

Kur bëjmë biznes në emër të ABKONS ne duhet të jemi larg influencës së drogës, alkoolit pa substanca të tjera të cilat rrezikojnë aftësinë tonë për të punuar të sigurt dhe me efikasitet. Ky rregull nuk zbatohet për rastet e sponsorizuara nga ABKONS apo rastet e tjera të lejuara ku mund të konsumohet alkool. Në raste të tilla lejohet konsumim i moderuar i alkoolit.

4.5 Respektimi i privatësisë

ABKONS është i angazhuar për të respektuar privatësinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

- Ne do të mbledhim, ruajmë dhe përpunojmë vetëm të dhënat personale të cilat janë të nevojshme për të kryer biznesin e ABKONS dhe do të trajtohen në pajtueshmëri me ligjin;
- Ne do të përpunojmë vetëm ato të dhëna personale në pajtim me ligjin në fuqi dhe politikat e mbrojtjes së të dhënave të ABKONS;
- Ne jemi të hapur dhe transparentë lidhur me faktin qe ne mbledhim të dhëna personale, çfarë të dhënash mbledhim dhe për çfarë qëllimi i përdorim;
- Ne nuk i shpërndajmë tek palët e treta, veçanërisht në vende të tjera, përjashto kur është në pajtim me ligjin në fuqi dhe politikat e ABKONS.

INTEGRITETI NDAJ KOMUNITETIT DHE MJEDISIT

Në ABKONS ne synojmë të ndikojmë pozitivisht në komunitetin ku zhvillojmë veprimtarinë tonë. Ne synojmë të shmangim ndikimet negative ndaj mjedisit. Ne në ABKONS zbatojmë standartet më të larta ligjore dhe praktikat më të mira.

5.1 Zhvillimi i komuniteteve që ndikohen nga ne

ABKONS përpiqet të jetë një kompani e përgjegjshme ndaj shoqërisë. ABKONS dëshiron të promovojë zhvillimin ekonomik dhe kulturor të komunitetit ku zhvillon veprimtarinë e tij. Një gjë të tillë do ta arrijë pjesërisht duke zbatuar një plan investimesh sociale. Po kështu ABKONS synon të shmangë, minimizojë, zbusë dhe/ose kompensojë të gjitha ndikimet e dëmshme të biznesit të saj. Për ta arritur këtë, ABKONS është i angazhuar së bashku me partnerët e tij përgjatë gjithë ekzistencës së tij, duke u mbështetur edhe tek praktikat më të mira ndërkombëtare.

5.2 Mbrojtja e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit është një nga prioritetet kryesore të ABKONS. Ne jemi të vetëdijshëm ndaj detyrimit për të kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm. Mbrojtja e mjedisit duhet të përfshihet në proçesin e planifikimit dhe zhvillimit të biznesit tonë. Ne do ta arrijmë këtë nëpërmjet angazhimit, përfshirjes dhe trajnimit të punonjësve si dhe nëpërmjet komunikimeve të hapura me partnerët tanë. Ne do të bëjmë përpjekjet maksimale për të minimizuar efektet negative ndaj mjedisit. Ne do të përpiqemi t'i përdorim burimet natyrore me efikasitet dhe në mënyrë të përgjegjshme.
Ne do të monitorojmë efektet tona ndaj mjedisit në vendet ku punojmë.

5.3 Ndalimi i rryshfetit dhe korrupsionit

Korrupsioni gërryen zhvillimin ekonomik të vendeve dhe shkatërron konkurrencën e lirë. Ai shkatërron reputacionin dhe ekspozon ndaj rriskut si individët ashtu edhe kompanitë.

ABKONS është kundër çdo lloj forme të korrupsionit, pavarësisht nëse bëhet drejtpërdrejt apo jo drejtpërdrejt nëpërmjet palëve të treta. ABKONS do të ndërmarrë veprime aktive për të siguruar që nuk do të ketë korrupsion në asnjë nga hallkat e tij të biznesit. ABKONS ndalon çdo formë të rryshfetit dhe korrupsionit.

Korrupsioni përcaktohet si abuzim me pushtetin për përfitim personal.

Korrupsioni përcaktohet si dhënie (korrupsioni aktiv) ose marrje (korrupsioni pasiv) të diçkaje me vlerë nga dikush në këmbim të një veprimi ose mosveprimi të kundërligjshëm.
Shembuj të korrupsionit përfshijnë:

- Akordim i një kontrate pa një proces të mirëfilltë tenderimi një kompanie të lidhur me një zyrtar publik. Zyrtari publik ofron në këmbim mbështetje politike;
- Dhënia e një dhurate një zyrtari publik për të patur një trajtim lehtësues lidhur me taksat;
- Ofrimi i një pune të afërmit të një zyrtari publik për të marrë një leje apo miratim prej tij;
- Drejtuesit të prokurimeve i jepen favore pasi i akordoi një kontratë një subjekti të caktuar.

5.3.1 “Pagesat Lehtësuese”

Ndalimi i rryshfetit përfshin edhe ofrimin/dhënien e shumave të vogla zyrtarëve shtetërorë të rangut të ulët për të siguruar apo përshpejtuar realizimin e një veprimi apo veprimeve rutinë për të cilat ne jemi ligjërisht përgjegjës. Të tilla pagesa nganjëherë quhen “pagesa lehtësuese”. Presioni “Kohë” nuk është një justifikim i pranueshëm për pagesa të tilla.

Mund të ekzistojnë situata kur kërkohet të bëhet një pagesë e tillë pasi mospagimi do të sillte një rrezik të menjëhershëm për shëndetin, sigurinë apo mirëqënien fizike të personit. Nëse pagesa është bërë në një situatë të tillë emergjence duhet të raportohet menjëherë tek Oficeri i Pajtueshmërisë së ABKONS sapo të jetë kryer si pagesë.

5.3.2 Dhuratat, argëtimet dhe mikpritja

Ofrimi i dhuratave dhe argëtimeve për partnerët e biznesit mund të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve të punës por nuk duhen përdorur me qëllimin e marrjes apo përfitimit të një veprimi apo mosveprimit pasi kjo mund të klasifikohet si rryshfet. ABKONS lejon "Dhuratat simbolike" që nuk kanë vlerën e një produkti të destinuar për treg por përcjellin vlera kulturore, mirënjohje, shpirtërore etj.

5.3.3 Palët e treta

ABKONS nuk mund të kosiderohet përgjegjëse për veprimet korruptive të palëve të treta gjatë punës që ata bëjnë për llogari të ABKONS. Përpara punësimit të palëve të treta, menaxherët duhet të sigurohen që reputacioni, aftësitë dhe e kaluara e tyre të jenë të përshtatshme dhe të kënaqshme.

ABKONS presupozon që palët e treta të veprojnë në pajtim me parimet e caktuara nga Kodi Ynë dhe që ky kusht duhet të parashikohet në kontratat e ABKONS me palët e treta.

5.3.4 Kontributet e bamirësisë dhe Sponsorizimet

Sponsorizimet janë një element i rëndësishëm i komunikimit të jashtëm të ABKONS dhe ato janë një mënyrë për të fuqizuar dhe bërë të njohur emrin e saj. Sponsorizimet ndryshojnë nga donacionet pasi synojnë të kenë një përfitim specifik.

Sponsorizimet mund të jenë problematike pasi të tjerëve mund t'iu duket si mënyrë për të përfituar avantazhe të pamerituara. Ne do të paguajmë për sponsorizim vetëm nëse nuk ka si qëllim përfitimin e avantazheve të pamerituara.

Kontributet e bamirësisë janë pjesë e angazhimit të ABKONS ndaj shoqërisë dhe një mënyrë për të kontribuar ndaj kauzave të vlefshme. Ato reflektojnë identitetin tonë si një kompani e përgjegjshme ndaj njerëzve. Donacionet janë çdo gjë e vlefshme e dhuruar nga ABKONS për të mbështetur kauza të bamirësisë pa patur pritshmërinë për të marrë mbrapsht përfitime për biznesin. ABKONS duhet të jetë i kujdesshëm kur bën donacione pasi edhe donacionet e mirëfillta nganjëherë mund të shihen si përpjekje për të përfituar një avantazh të pameritуar. Ne do të bëjmë donacione vetëm nëse nuk ka si qëllim përfitimin e avantazheve të pamerituara.

Kontributet e bamirësisë dhe sponsorizimeve bëhen me miratimin paraprak të Drejtuesve të Abkons.

5.4 Kundër Pastrimit të Parave

ABKONS nuk pranon, lehtëson apo mbështet pastrimin e parave.
Pastrimi i parave është proçesi i përpjekjes së fshehjes së faktit se paratë kanë si burim një aktivitet kriminal. Qëllimi është të bëjnë të duket sikur këto para rrjedhin nga një biznes i ligjshëm.

- Ne gjithmonë duhet të jemi në pajtim me ligjet dhe rregulloret për pastrimin e parave dhe duhet të raportojmë çdo transaksion të dyshimtë;
- Ne duhet të shmangim marrjen e pagesave apo përfshirjen në transaksione apo aktivitete ku fondet mund të kenë si burim një aktivitet kriminal, duke zbatuar procedurat financiare dhe të prokurimeve të ABKONS;
- Ne duhet të ndërmarrim masa të përshtatshme dhe të arsyeshme për të identifikuar dhe vlerësuar integritetin e palëve të treta me të cilët ne punojmë.

5.5 Lobimi dhe aktivitetet politike

Ju keni të drejtë të merrni pjesë me vullnetin tuaj në një proces politik përfshirë edhe dhënien e kontributit personal politik. Gjithsesi ju duhet ta bëni të qartë se bindjet dhe veprimet tuaja personale nuk përfaqësojnë ato të ABKONS.

Po ashtu, ju asnjëherë nuk mund të përdorni fondet, asetet apo burimet e ABKONS për të mbështetur një kandidat apo parti politike.

- Ne nuk do të marrim pjesë në një aktivitet politik;
- Ne nuk do të kontribuojmë politikisht, as në para e as në ndonjë formë tjeter;

ABKONS angazhohet në debate rreth politikëbërjes për tema mbi të cilat ABKONS ka një interes legjitim për stafin e tij, si dhe për komunitetin ku operon, në mënyra të ndryshme përfshirë edhe lobimin. Aktivitetet lobuese janë të mirërregulluara dhe duhet të bëhen vetëm nga njerëz të autorizuar të ABKONS.

INTEGRITETI NDAJ PARTNERËVE

Ne gjithmonë ruajmë standartin më të lartë etik të ndershmërisë dhe integritetit. Në këtë mënyrë ne kemi fituar besimin e partnerëve tanë.

6.1 Mbrojtja nga prokurimet jo etike

ABKONS është shumë i rëndësishëm për vendet dhe rajonet ku zhvillon aktivitetin e tij. Ekziston një interes i madh për të fituar kontrata me ABKONS. Është shumë e rëndësishme që ABKONS të qëndrojë neutral ndaj presioneve të jashtme.

Të gjitha mallrat dhe shërbimet prokurohen nga furnitori i cili ofron çmimin, cilësinë dhe nivelin e shërbimit më të mirë

Furnitorët përzgjidhen duke përdorur një proces tenderimi transparent, jo-diskriminues dhe konkurues për të gjitha mallrat dhe shërbimet. Kriteret për vlerësimin e tenderave janë të disponueshme dhe publike. ABKONS kryen një verifikim të të gjithë furnitorëvë të cilët kryejnë aktivitet me rrezikshmëri të lartë për llogari të tij për tu siguruar se ato kanë një reputacion etik solid.

- Ne nuk do ta angazhojmë ABKONS në detyrime kontraktuale përtej fushës deri ku shtrihet autoriteti ynë;
- Ne do të sigurojmë që të ketë një ndarje të saktë të detyrave në procesin e prokurimit;
- Ne do të lidhim vetëm kontrata me shkrim me partnerët tanë të biznesit. Dokumenti i shkruar do të përshkruajë marrëdhënien e vërtetë ndërmjet ABKONS dhe partnerit në biznes;
- Ne do të sigurohemi se kompensimi është proporcional me shërbimin e kryer;
- Ne do të përdorim vetëm një partner biznesi i cili plotëson kërkesat e ABKONS mbi integritetin.
- ABKONS synon që furnitorët të përdorin në marrëdheniet me ne të njëjtat kualifikime teknike dhe standarte etike si ABKONS.

6.2 Shmangia e konflikteve të interesit

"Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.Konflikti i interestit mund të jetë: faktik; në dukje; i mundshëm;rast për rast; i vazhdueshëm.

Të gjitha transaksionet e biznesit duhet të realizohen duke patur parasysh interesin më të mirë të ABKONS. Duke qenë se të tilla situata nuk janë gjithmonë të qarta dhe të dukshme, ju duhet t'i tregoni ato menjëherë tek drejtuesi i linjës, përfaqësuesi kontraktual, në mënyrë që ABKONS të mund t'i menaxhojë, monitorojë dhe vlerësojë si duhet ato.

6.3 Ruajtja e saktësisë së biznesit dhe e të dhënave financiare

Të dhënat financiare dhe ato të biznesit janë thelbësore për suksesin tonë. Integriteti dhe saktësia e këtyre të dhënave janë baza e asaj çfarë ne i raportojmë investitorëve, kreditorëve, agjensive shtetërore dhe partnerëve të tjerë. Të dhënat tona financiare dhe ato të biznesit duhet të jenë transparente, të plota dhe në pajtim me rregullat e pranuara të financës dhe ligjeve të tjera në fuqi.

- Ne do të krijojmë dhe mbajmë një sistem të fortë dhe efektiv kontrolli të brendshëm në mënyrë që investitorët dhe partnerët e ABKONS të jenë të sigurtë se paratë e tyre po shpenzohen me zgjuarsi;
- Ne do të sigurohemi se të gjitha transaksionet e biznesit do të regjistrohen në kohë, plotësisht dhe me saktësi në regjistrat e kontabilitetit të ABKONS në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe me standartet kryesore të kontabilitetit;
- Mbajtja e dokumentacionit duhet të bëhet në pajtim me udhëzimin tonë për mbajtjen e dokumentacionit. Ai nuk duhet të asgjësohet asnjëherë kur jemi para një hetimi apo auditimi. Kontaktoni Departamentin e Pajtueshmërisë nëse keni dyshime lidhur me asgjësimin e të dhënave.

6.4 Ruajtja e aseteve të ABKONS

Ne na janë besuar asetet e ABKONS dhe jemi personalisht përgjegjës për mbrojtjen e tyre dhe përdorimin e tyre me kujdes. Në asetet e ABKONS përfshihen: koha e ABKONS, fondet, pajisjet e IT, materialet, mjediset, informacioni dhe dosjet, databazat, programet dhe të gjitha të dhënat e tjera, dokumente, shkrime, kopje dhe informacione të formave të ndryshme të përdorura nga ju apo që kanë të bëjnë me ju gjatë punësimit tuaj.

- Ne do të sigurojmë që asetet e ABKONS nuk do të humbasin, dëmtohen, keqpërdoren apo harxhohen pa kriter;
- Ne do të sigurojmë që asetet e ABKONS nuk do të përdoren për të mbështetur një biznes të jashtëm apo një aktivitet të paautorizuar;
- Nuk inkurajohet përdorimi personal i aseteve të ABKONS, përdorim i cili mund të jetë në nivel shumë minimal dhe të mos ndikojë në prodhimtarinë dhe mjedisin e punës;
- Mos e ndani fjalëkalimin me të tjerët dhe mos lejoni njerëz të tjerë, përfshirë miq dhe familjarë të përdorin burimet e ABKONS;
- Nëse dyshoni për vjedhje apo mashtrim lidhur me asetet e ABKONS njoftoni menjëherë drejtuesin tuaj ose Departamentin e Pajtueshmërisë.

6.5 Shmangia e tregtisë së brendshme

Ne nuk duhet të tregtojmë aksionet e aksionerëve tanë apo partnerëve të biznesit bazuar në informacione "materiale" jopublike të cilat ne i kemi mësuar rreth asaj kompanie gjatë punës që ne kemi bërë për llogari të ABKONS. Po kështu dhënia e informacioneve të fshehta është e ndaluar.

Informacioni konsiderohet "material" nëse një investitor i arsyeshëm do ta konsideronte të rëndësishëm për të blerë, shitur apo mbajtur aksionet. Informacion "jopublik" do të thotë informacion i cili akoma nuk është bërë i njohur për publikun. Jemi në rastin e dhënies së informacioneve të fshehta kur ne i japim një personi informacion "material" jopublik dhe pastaj ai person tregton për llogari tonën.

6.6 Komunikimi me palët e tjera

ABKONS duhet të flasë me një zë kur zbulon apo jep informacion për palët e tjera të interesuara. Është shumë e rëndësishme që vetëm persona të autorizuar të flasin në emër të ABKONS.

- Komunikimi me palët e interesuara do të bëhet në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Ne nuk do të bëjmë deklarata publike rreth ABKONS apo aktivitetit të tij të biznesit përveçse kur jemi të autorizuar për ta bërë një gjë të tillë;
- Ne do të sigurojmë që dokumentat të rishikohen dhe miratohen nga partnerët (drejtuesit) e ABKONS përpara se të shpërndahen jashtë organizatës

6.7 Përdorimi i medias sociale

Ne duhet te jemi të kujdesshëm kur shkruajmë komunikime të cilat mund të publikohen online. Nëse jeni pjesëmarrës i forumeve online si blogje, chat rooms apo news groups mos lini asnjëherë përshtypjen se po flisni në emër të ABKONS dhe së dyti përpara se të shtypni butonin”dërgo”mendojeni edhe një herë.

Ne nuk duhet të dërgojmë e-mail ose të postojmë informacion ose material konfidencal që mund të përceptohen si cënuese për reputacionin tonë.

INTEGRITETI NDAJ TREGUT

ABKONS angazhohet p±r integritet dhe ndershm±ri kur konkurron me t± tjer±t n± treg. Sjelljet t± cilat c±nojn± konkurrenc±n nuk jan± t± tolerueshme. ABKONS do t± konkurroj± n± m±nyr± etike brenda hap±sir±s ligjore lidhur me rregullat mbi konkurrenc±n dhe antitrustin t± cilat jan± t± zbatueshme p±r ABKONS.

7.1 Antitrusti

Ligjet antitrust ndalojnë marrëveshje apo veprime të cilat mund të eleminojnë apo dekurajojnë konkurrencën, mund të krijojnë një monopol, mund të abuzojnë me një pozicion dominant në treg, mund të mbajnë artificialisht çmimet ose që mund të vështirësojnë apo pengojnë ilegalisht tregtinë.

- Ne nuk do të bëjmë marrëveshje për ndarjen e tregjeve, zonave ose konsumatorëve;
- Ne nuk do të bëjmë marrëveshje për të mos konkurruar;
- Ne nuk do të diskutojmë proceset të cilat lidhen me pjesëmarrjen në tendera;
- Ne nuk do të shkëmbejmë informacione rreth çmimeve, përqindjeve të tregut apo kushteve të tjera të tregut, me konkurrentët, klientët apo palët e treta në shkelje të ligjeve në fuqi;
- Ne nuk do të ndihmojmë firmat konkurruese që ata të koordinojnë sjelljet e tyre në shkelje të ligjeve të konkurrencës.

7.2 Mbledhja e informacionit mbi konkurrentët

Të gjitha informacionet që mblidhen rreth konkurrentëve duhet të mblidhen në mënyrë publike, etike dhe ligjore.

ZBATIMI PRAKTIK

Kur jeni të pasigurtë nëse po veproni siç duhet, bëjini vetes pyetjet e mëposhtme:

Sjellja ime na jep vallë ne mundesinë të ruajmë besimin e kompanisë?A jam konsultuar si duhet?

A do të mendojnë familjarët e mi, miqtë dhe kolegët se sjellja ime ishte etike?

A kam menduar se çfarë ndikimi do të ketë sjellja ime tek ata që preken prej saj?

A do të ndihesha unë komod nëse dikush do të sillej ashtu ndaj meje?

A do të isha komod nëse vendimi im dilte nesër në gazetë?

A është sjellja ime e ligjshme dhe në pajtim me politikat e ABKONS?

abkons

LOCAL Knowledge, GLOBAL Standarts

abkons
Themistokli Gërmenji Str.
Pranë RTVSH, Kati 2
Tirana/Albania
Tel/Fax ++355 4 22 58 326
Web Page: www.abkons.com